Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit

93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

**23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës** 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

---

## **DH. ANKESAT**

### **25. Procedura e ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

**SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....
- Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....
- Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....
- Shtojca 7. Termat e referencës
- Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....
- Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....
- Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit .....
- Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
- Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
  - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					



---

Datë _____	
------------	--

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

*Shënim: Përcaktohen specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

#### 1. Të përgjithshme

Për realizimin e lidhjes së internetit në Spitalin Rajonal Korçë dhe Poliklinikës së Specialiteteve Korçë, është e nevojshme që krahas ndërtimit të rrjeteve lokale të brendshëm, të sigurohet një rrjet i qëndrueshëm dhe me kapacitet të mjaftueshëm midis Spitalit Rajonal Korçë dhe Poliklinikës së Specialiteteve Korçë.

Ky rrjet duhet të jetë i sigurtë dhe i mbrojtur.

Qëllimi i kësaj kontrate është ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimit LAN/WAN.

#### Indikatorët e cilësisë :

1. Operatori duhet të jetë i regjistruar pranë RIPE NCC (European IP Network Network Coordination Centre).
2. Operatori duhet të jetë i regjistruar pranë regjistratit të AKEP për ofrimin e shërbimit, për këtë të paraqesë autorizimin përkatës.
3. Operatori duhet të paraqesë skemat përkatëse për të gjitha lidhjet fizike.

- 
4. Ofruesi duhet të aplikojë dhe të garantojë teknika të cilësisë së shërbimit duke optimizuar transferimin e të dhënave dhe duke mundësuar parametrat e duhur për aplikimin e një rrjeti të konvergjuar me përmbajtje të dhënash.
  5. Vonesa e transmetimit (Round Trip Delay) për të gjithë lidhjet midis Spitalit Rajonal Korçë dhe Poliklinikës duhet të jetë me e vogël se 10ms.
  6. Rrjeti i Operatorit duhet të jetë bazuar në teknologjinë MPLS
  7. Rrjeti i operatorit duhet të jetë i mbrojtur në nivel backbone.
  8. Rrjeti i Operatorit duhet të jetë në gjendje të suportojë kapacitete të larta mbi 1 Gbps.
  9. Disponueshmëria e shërbimit CIR 99.9 %.
  10. Operatori duhet të ofrojë një SLA prej të paktën 99.9%

#### **Instalimet e Rrejtit dhe Telefonisë :**

1. Mënyra e ofrimit të këtij shërbimi të jetë me transmetim me fibër optike.
2. Kapacitetet e rrejtit për çdo pikë duhet të jenë simetrike, dhe me mundësi zgjerimi dhe konfigurimi me kapacitete të ndryshme.
3. Ofertuesi duhet të mbështesë shërbimin edhe në një rrjet dytësor (Intranet dhe Internet ) që do të shërbejë si zgjidhje backup për garantimin e komunikimit të pandërprerë ofertues - datacenter 2 midis Spitalit Rajonal Korçë dhe Poliklinikës nëq ka problem me fibrat optike në datacenter 1. Ky është detyrim dhe shpenzim i ofruesit të shërbimit.
4. Rrjeti në shërbim të Spitalit Rajonal Korçë dhe Poliklinikës duhet të jetë i dedikuar.
5. Rrjeti dhe shërbimi nuk duhet të prekin në asnjë mënyrë konfigurimin e tanishëm të adresave IP të rrjetit të Spitalit.
6. Ofruesi duhet të krijojë dhe garantojë brenda rrjetit të tij, një rrjet apo qark virtual për Spitalin, që do të izolojë trafikun e saj nga pjesa tjetër e këtij rrjeti. Rrjeti i ofruesit duhet të jetë transparent ndaj trafikut IP dhe me lart.
7. Shërbimi i kërkuar duhet të ofrohet në Spitalin Rajonal Korçë dhe Poliklinikës sipas listës së mëposhtme brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga firmosja e kontratës.
8. Operatori duhet të zotërojë një infrastrukturë të vetën me fibër optike pa ndihmën e paleve të treta.
9. Rrjeti duhet të jetë transparent ndaj mekanizmave QoS të niveleve të tjera që mund të aplikojë vetë përdoruesi (ndarja e shërbimeve në klasa, precedenca IP, rezervim bandwidth-i, Optimizim WAN-i etj).
10. Lidhja fizike duhet të jetë e menaxhueshme dhe të ketë aftësi raportuese apo alarmuese në rast difektesh apo anomalish të ndryshme.
11. Operatori duhet të garantojë zgjerim të brezit brenda 24 orësh në rast se do të kërkohet nga Spitali Rajonal Korçë.
12. Operatori duhet të jetë në gjendje që me kërkesë të Spitalit të realizojë mbrojtje me teknologji dhe pat të ndyshëm të pikave të caktuara për një periudhë kohore të shkurtër.
13. Operatori duhet ti ofrojë akses të plotë në modem/router të institucionit për monitorimin e internetit për funksione të IT, si monitorim i shpejtesisë, bllokime në firwalle etj.
14. Numrat e telefonit fiks do të ngelen të njëjtët në bazë të kërkesave të sipër përmëndura më lart në tabelë.

- 
15. Pas mbarimit të minutave kombëtare dhe ndërkombetare të cilësuar më lart numuri të mos ketë të drejtë të kryejë telefonata me kosto shtesë.
  16. Pajisjet e instaluar nga Kontraktuesi në mjediset e Autoritetit Kontraktues për të kryer lidhjen me rrjetin e internetit dhe telefonik, janë në pronësi të Kontraktuesit dhe i kthehen atij në përfundimin apo zgjidhjen e parakohshme të kësaj kontrate.
  17. Pajisja do të bëhet në baza 1 mujore me paspagim.

#### **Funksionimi i Rrjetit:**

1. Shërbimi duhet të ofrohet 24/7 (24 orë në 7 ditë të javës).
2. Rrjeti i ofruar duhet të lejojë Spitalin Rajonal Korçë të përdorë software dhe hardware që ajo zgjedh vetë, në funksion të aplikimeve që do të përdorë.
3. Rrjeti duhet të jetë virtualisht i izoluar nga rrjetet e përdoruesve të tjerë.

#### **Monitorimi i rrjetit ;**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë përshkrimet për Qendrën e Operacioneve të Rrjetit, strukturën e help-desk-ut dhe shërbimit, dhe strukturën e vetë rrjetit.
2. Rrjeti duhet të monitorohet nga Operatori në të gjithë hallkat e tij, duke përdorur protokolle standarte të monitorimit dhe sinjalizimit.
3. Monitorimi i rrjetit dhe pajisjeve duhet të bëhen në qendër dhe nga distanca duke përdorur mjete të përshtatshme (psh SNMP për pajisje etj).
4. Operatori duhet të ofrojë shërbimin "Help Desk". Ky shërbim konsiston në mirëmbajtjen e rrjetit, asistencë online për të gjithë problemet me rrjetin. Shërbimi Help Desk është i kontaktueshëm nga stafi i Spitalit Rajonal Korçë 24/7/365 ditë të vitit duke përfshirë ditët e shtunëa dhe të diela si dhe festat zyrtare në kohë reale.

#### **Zgjidhja e problemeve :**

Konstatimi dhe riparimi i difekteve në linjë dhe/ose në pajisje që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi brenda afateve të mëposhtme:

1. Koha e përgjigjes duhet të jetë brenda 10 minutash
2. Koha e zgjidhjes së problemit në të gjithë rrjetin duhet të jetë brenda 4 orësh.
3. Mbështetje aktive në institucion deri në zgjidhjen e problemit.

#### **Mirëmbajtja e rrjetit :**

1. Për çdo problem të mundshëm apo riparim që do të bëjë Operatori përkatës, duhet të lajmërojë minimumi 7 (shtatë) ditë para ndërprerjes.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen:

Nr	Përshkrimi	Nr. i Telefonit	Mënyra e Lidhjes	Kapaciteti Download/Upload pa limit	Shënime
1	Financa	82254680	Fiber Optike	50 Mb / 50 Mb IP Dinamike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit, Modemi ndodhet 50m larg telefonit
2	Urgjenca	82242972	Fiber Optike	50 Mb / 50 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit + 50 Minuta Kombëtare me të gjithë operatorët ne muaj, Modemi ndodhet 50m larg telefonit
3	Poliklinika 1	82243121	Fiber Optike	50 Mb / 50Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit, Linjë Backup (Linja Backup te jete active kur bie linja kryesore)
4	Materniteti 1	82243130	Fiber Optike	50 Mb / 50 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit
5	Telemjeksia	82254033	Fiber Optike	50 Mb / 50 Mb IP Statike	_____
6	Nen Drejtoria	82242674	Fiber Optike	20 Mb / 20 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit + 50 Minuta Kombëtare ne muaj, me të gjithë operatorët
7	Farmacia	82244528	Fiber Optike	20 Mb / 20 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit, IPTV (Paketa Baze)
8	Pediatria	82242916	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit
9	Sanatoriumi	82242668	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit, Modemi ndodhet 50m larg telefonit
10	Mjekësia Ligjore	82244475	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit
11	Materniteti 2	82242788	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit

12	ORL	82242868	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit, Modemi ndodhet 50m larg telefonit
13	Reanimacini	82242742	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit
14	Drejtoria	82242755	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta brenda rrjetit fiks pa limit + 50 Minuta Kombëtare dhe ndërkombëtare ne muaj, me të gjithë operatorët
15	Banka e Gjakut	82257880	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm brenda rrjetit fiks pa limit
16	Poliklinika 2	82257878	Fiber Optike	10 Mb / 10 Mb IP Statike	Minuta vetëm Brenda rrjetit fiks pa limit
17	Urgjenca 2	82242555	_____	_____	Ky numër shërben vetëm për telefonata hyrëse. (Operatori ekonomik kontraktues duhet te siguroje 1 aparat telefonik fiks)

Afatet e ekzekutimit: **Per sa i perket sherbimit qe do te kryhet, do te percaktohet rast pas rasti ne minikontratat qe do te lidhen, ne zbatim te marrveshjes kuader, sipas nevojave te AK.**

- **Argumentim:** Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar,  
Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.



---

**Shtojca 7**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Sherbimi interneti dhe telefonie, per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Korce.

Detyrat: Sherbimi interneti dhe telefonie, per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Korce.

Shpërndarja: 24 Muaj

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne Spitalin Korce dhe ne Polikliniken e Specialiteteve Korce

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*; Shuma e sigurimit të ofertës është **32,016** (tridhjetë e dy mijë e gjashtembdhjetë)

Mbeshtetur në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, Autoriteti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korce, specifikon mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

- në formën e garancisë bankare; ose
- nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare **X**
- ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

***Pasi institucioni yne nuk disponon llogari bankare ku mund te behet pagesa e vleres se sigurimit te ofertes.***

b. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcë 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

---

## 2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit) 2018-2019-2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit që konkurron. Per kete operatori ekonomik duket te dorezoje vertetim leshuar nga Dega e tatim Taksave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Fondi limit eshte **1,600,800** leke pa TVSH,

**40% e 1,600,800 = 640,320 leke pa TVSH.**

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2018-2019-2020) duhet të jetë jo më e vogël se **640,320** leke pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar *Ligji Nr . 9920, datë 19.5.2008 Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 Per tatimkin mbi te ardhurat si dhe Udhezimi Nr.5, datë 30.01.2006 Per Tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar pika 3.12 “Deklarimi tatimor dhe Llogaritja perfundimtare e detyrimit”.*

## 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim\*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sherbimit të pritshme qe ofertohe.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është **1,600,800** leke pa TVSH,

**20% e 1,600,800 = 320,160 leke pa TVSH.**

Pra vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jetë në një vlerë jo më të vogël se **320,160** leke pa TVSH.

**2.2.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Operatori duhet të ketë të paktën 3 të punësuar inxhinierë IT, telekomunikacion ose/dhe elektronik nga të cilët:

- **1 (një)** Inxhinier të certifikuar CCNA Routing & Switching ose ekuivalente Ky lloj certifikimi kërket për arsye se inxhinierët e kompanisë fituese të jenë të aftë teknikisht për të kryer instalimet e rrjetit, konfigurimet dhe t’ju përgjigjen në kohë problemeve për zgjidhjen e tyre.

- **1 (një)** Inxhinier të certifikuar CCNA Security ose ekuivalente

Kjo certifikatë kërkohet pasi kompania duhet të ketë inxhinierë të aftë për të zgjidhur problemet në fushën e sigurisë të infrastrukturës të rrjetit duke parandaluar dhe hequr kërcënimet e mundshme që cenojnë sigurinë e saj.

- **1 (një)** Inxhinier IT, Telekomunikacion ose edhe Elektronik.

*(Shënim: Dokumentacioni provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar, kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës për punonjesve të kërkuar, minimalisht për vitin 2021.
- Listpagesat minimalisht për vitin e fundit të ushtrimit të aktivitetit të tij (minimalisht 2021).

---

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjesit e kerkuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.3.1** Operatori duhet të jetë i rregjistruar pranë RIPE NCC (European IP Network Network Coordination Centre).

**2.3.2** Operatori duhet të jetë i rregjistruar pranë regjistrit të AKEP për ofrimin e shërbimit, për këtë të paraqesë autorizimin përkatës.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm



<p>për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ëeb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ëeb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ëeb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
